



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	02.12.2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtjese Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPNS40K	7602/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.935/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani kryetar, Malsore Gashi Bajraktari, dhe Arben Mehmeti, anëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A. Nr. 935/2022, të datës 21.10.2022, së ankeses nga Komuna e Obiliqit, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.11.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 935/2022, të datës 21.10.2022, së ankeses

II.Mbetet NË FUQI, Vendimi i datës 22.09.2022, me numër protokolli 242 i Njesisë së Burimeve Njerëzore, në Komunën e Obiliqit, si dhe Vendimi i datës 13.09.2022, me numër protokolli 232, i Udhëheqës së Personelit në Komunën e Obiliqit.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 21.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur m zhvillimi i procedurës së rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Biblioteka 4”, nga Komuna e Obiliqit, është bërë në kundërshtimi me ligjin.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 24.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Obiliqit, Ndërsa me datë 11.11.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 935/2022, e datës 21.10.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Certifikatë e datës 29.08.2022; Vendimi i datës 20.09.2022, me numër protokolli 242, i Njesisë së Burimeve Njerëzore; Konkursi i datës 03.08.2022; Vendimi i datës 08.09.2022, me numër protokolli1227, për Themelimin e Komisionit të Pranimit; Vendimi i datës 12.09.2022; Lisat e Aplikanteve; Vendimi i datës 20.09.2022, me numër protokolli 242, i Njesisë së Burimeve Njerëzore; Vendimi i datës 13.09.2022, me numër protokolli 232, i Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Obiliqit; Aplikacioni i Merita Shabani, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 10.03.2011; Diplomë e datës 23.05.2001; Kontrata për marrëveshje shërbime të veçanta e datës 05.10.2018; ; Kontrata për marrëveshje shërbime të veçanta e datës 08.09.2017; Përgjigje në ankesë e datës 22.11.2022, me numër protokolli 7303/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji, nga shkresat e administruara të lëndës konstaton së në konkursin e shpallur 25.08.2022 nga Komuna e Obiliqit, për pozitën " Zyrtar për Biblioteka 4", kriteret formale të konkursit kanë qenë:

- *Diplome Universitare, me të paktën 180, kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to,*
- *Fusha e kërkuar Ekonomik(pa specifikim), Sociologji, Antropologji . Filozofi, Histori, Shkenca Politike Pune sociale*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën " Zyrtar për Biblioteka 4", nga Komuna e Obiliqit, i ka analizuar provat relevantë, pasi që ka analizuar provat, ka konstatuar se ankuesja në rastin e dorëzimit të aplikacionit, nuk e ka dorëzuar certifikatën nen hetime, ashtu siç është kërkuar me datë 25.08.2022 nga Komuna e Obiliqit, për pozitën " Zyrtar për Biblioteka, dhe mbi bazën e kësaj, kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankueses nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Obiliqit, në rastin e nxjerrjes të datës 22.09.2022, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit Merita Shabani, ka vepruar në pajtim me neni 15, parafi 5, dhe 6, të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet së; 5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim më paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht



aplikantëve, jo më vonë se katermbëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 6. Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Udhëheqja e Burimeve Njerëzore e Komunës së Obiliqit, me nxjerrjen e Vendimit të datës 13.09.2022, me të cilin ka refuzuar aplikacionin e ankuesit, me arsyetimin se nuk i plotëson kushtet e përgjithshme, për tu përfshirë në listën e ngushtë, ka vepruar në pajtim, në pajtim me nenin 15, paragrafi 1,2,3, të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare qëndër lidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë.

Ndërlidhur me zhvillimin e procedurës për pozitën "Zyrtar për Biblioteka 4", nga Komuna e Obiliqit. Kolegji konstaton se ankuesja nuk është përfshirë, në listën e Ngushtë për "Specialist i Shkencave Shoqërore", për pozitën „Zyrtar për Biblioteka 4”, nga Komuna e Obiliqit, Njësia e Burimeve Njerëzore, për mes vendimit të datës 13.09.2022, i ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se ankuesja nuk ka ofertuar certifikatën nën hetime, dhe se nuk mund të vazhdojë, në fazat tjera të procedurës, prandaj kolegji konstaton se Udhëheqësja e Personelit e Komunës së Obiliqit, ka vërtetuar drejte gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, i ka shqyrtuar edhe pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se është refuzuar për arsye të pa njohura, dhe se nuk e kam certifikatën nën hetime, duke e bashkangjitur certifikatën e datës 29.08.2022, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, duke ja bashkangjitur këtë certifikatë ankesës së parashtruar në Këshill, dhe pas kësaj dëshmie ti mundësuar që mund të vazhdojë në fazat tjera të procedurës, kolegji, konstaton se pretendimet ankimore të ankueses, nuk janë të bazuara sepse ankuesja, në bazë të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse ankuesja ka qenë e obliguar që të plotësojë Aplikacionin për punësim me dëshmitë e kërkuara, sipas konkursit të shpallur 25.08.2022 nga Komuna e Obiliqit, për pozitën "Zyrtar për Biblioteka 4", në pajtim me kriteret e kërkuara, në konkursin e publikuar nga Komuna e Obiliqit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.935/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.